



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 23.12.2019

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 18.12.2019 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Bashkimi Meti" për aktivitetin: "Ndertimi i rrugeve në lagjet Canolli, Qazimaj dhe Sekiraqa në Prapashticë" me numër të prokurimit: 616 -19-8305-521 nxjerr:

VENDIM

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekono**"Bashkimi Meti"** e datës 18.12.2019 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndertimi i rrugeve në lagjet Canolli, Qazimaj dhe Sekiraqa në Prapashticë", Nr. Brendshëm 616 19 185 521 kundër *Njoftimit* të datës 13.12.2019, të publikuar në web-faqe të KRPP-së.
2. Vërtetohet Njoftimi i autoritetit i publikuar me datë: 06.02.2019;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te vazhdoj respektimin e Vendimit të publikuar*.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Operatori Ekonomik **"Bashkimi Meti"** me datë 18.12.2019 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndertimi i rrugeve në lagjet Canolli, Qazimaj dhe Sekiraqa në Prapashticë" me Nr.616 19 8305 521 Nr. Brendshëm 616 19 185 521".

Autoriteti Kontraktues, me datë 20&23.12.2019, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës janë plotësisht të pa bazuara për arsye në vijim:

-Pretendimi se tenderuesi i propozuar per dhenje te kontrates eshte i pa pergjegjshem sepse nuk ka automjete me regjistrim valid eshte i pa bazuar per faktin se ne kerkesat e dosjes nuk ka asnje lloj kerkese per validitet te regjistrimit dhe edhe sikur te ishte ato automjete kane pase validitet deri me datat 19.09.2019 dhe 29.10.2019 qe do te ishte nje shmangje josubstanciale per kete aktivitet.

-Poashtu eshte i pabazuar pretendimi se tenderuesi i propozuar nuk ka ofruar Vendimin per menaxherin e projektit, pasi qe nje forme e tille nuk eshte kerkuar, ndersa tenderuesi ka paraqitur deshmita e kerkuara per stafin dhe te dokumentet e Anita Sadikaj ka shenuar se eshte menaxhere e projektit.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne sqarimet e paraqitura më lartë dhe në sqarimet detale nga Vendimi për anulim ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit